

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
**OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA**

C.nr.565/13

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: **ngatë cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson** **ngatë kundër të paditurit** **ngatë tani me vendbanim të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av.**, për vërtetim pronësie, pas mbajtjes së seancës kryesore në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe përfaqësuesit të të paditurit të datës: 23.02.2015, me datën 23.04.2015 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VERTETOHET** se paditësi: **ngatë** **është pronar** në bazë të mbajtjes me mirëbesim për më tepër se vite i sipërsaqes prej **m<sup>2</sup>**, pjesë e ngastrës kadastrale nr. **ZK**,
- III. **OBLIGOHET** i paditurit **që** **të drejtë** e specifikuar në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njehin paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojë regjistrimin e kësaj të drejtë në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi me anë të padisë dhë në deklarimet e të autorizuarit të saj në seanca gjyqësore kërkoi nga gjykata që të vërteton se paditësja është pronare mbi bazën e shithblerjes dhe mbajtjes me mirëbesim për më tepër se vite i paluajtshmërisë pjesë e ngastrës P-**ZK** në

Meqenëse tē paditurit nuk i dihej vendbanimi, gjykata duke vepruar konform propozimit tē tē autorizuarit tē paditësit e pas shterjes së mijeteve rrëth sigurimit tē adresës eventuale tē tē paditurit, tē njëjtë ia ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Përfaqësuesi i përkohshëm i tē paditurit tē parë nē seancë kryesore dhen fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, çështjen e vendosjes ja lë Gjykatës. Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Në fjalë përfundimtare i autorizuari i paditëse deklaroi se pari beje precizimin te pjesës së ngastrës kadastrale nr. ne sipërsaqe prej

m2, me tutje shtoi se duke marr parasysh provat e administruara u vërtetua fakti qe paditësi është pronar i pjesës se ngastrës kadastrale nr. ne sipërsaqe prej m2, ne bazë tē blerjes dhe mbajtjes, andaj i propozoj gjykatës që tē aprovoi padinë dhe kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Në seancë krvesore gjykata dëgjoi dëshmitarët: dhe

Me qëllim tē vërtetimit sa më tē plotë tē gjendjes faktike gjykata administroi këto prova: ekspertiza gjeodete e dt.21.01.2015 bashkë me kopjen e planit dhe skicën e terenit tē parcelës kontestuese, certifikata e pronësisë me nr. tē njësisë e dt. Së lëshimit 23.01.2015, procesverbal i daljes në vend.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe tē gjitha së bashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto përfundime:

Nuk është kontestuese se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese e ka nē posedim, pasi këtë fakt gjykata e vërtetoi nē momentin e daljes në teren, e po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekspertiza gjeodete.

Nuk është kontestuese se ngastra nē tërësi evidentohet nē emër tē tē paditurit, ky fakt vërtetohet nē bazë tē certifikatës së pronësisë.

Sa i përket çështjes së shitblerjes dhe periudhës së mbajtjes, e po ashtu edhe mirëbesimit nē mbajtje, nē mungesë tē provave tjera për tē dëshmuar këtë fakt gjykata u bazua nē deklarimin e dëshmitarëve, tē cilët deklaratat e tyre ia dhanë nën betim.

Dëshmitari deklaroi se para 50-60 viteve paraardhësi i paditësit e kanë blerë atë tok nga një serb, emri i te cilit nuk me kujtohet për momentin, por e di se edhe pjesa tjetër ku unë dhe fqinjët tjerë tē cilët i kemi tē ndërtuara shtëpitë figurojnë nē emër tē serbit e i cili nē atë kohe ka shkuar nē , nuk me kujtohet çmimi e as sipërsaqja, ne atë kohe kanë qenë tē ndërtuara dy dhoma me qerpiç nē atë vend, ndërsa pas lufte e ka ndërtuar një shtëpi tē re, ndërsa nuk e di që dikush ta këtë penguar rrëth shfrytëzimit tē kësaj parcele.

Ndërsa dëshmitari  
evidentohet në emër të një serbi  
5-6 vjeçare kur familja e  
pastaj e kanë ndërtuar një shtëpi e cila është ndërtuar para lufte, dhe që  
nga ajo kohë banojnë në atë pjesë dhe të njëjtëve askush nuk ja ka  
kontestuar të drejtën për këtë truall që e shfrytëzojnë pa kurrfarë  
pengese.

deklaroi se e tërë ajo lagje  
unë kam qenë në moshën  
është vendosur në atë lagje dhe me  
nga ajo kohë banojnë në atë pjesë dhe të njëjtëve askush nuk ja ka  
kontestuar të drejtën për këtë truall që e shfrytëzojnë pa kurrfarë  
pengese.

Dy dëshmitaret nuk janë në lidhje familjare me paditësin, të njëjtit në  
deklaratat e tyre ishin të sinqertë, dhe ishin në moshë të shtyre.

Deklaratat e këtyre dëshmitarëve rrëth blerjes se truallit dhe ndërtimit të  
shtëpisë po ashtu përputhen edhe me faktin se me rastin e daljes në  
teren gjykata konstatoi shtëpi dy kate me oborr prapa, anash dhe  
përpara si dhe një shtëpi e pa banueshme një kate.


Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi  
Marrëdhëni Themelore Juridike Pronësore, 28 të këtij Ligji. Mirëpo kjo  
e drejtë parashihet dhe me nenin 40 të Ligjit për Pronësinë dhe Të  
Drejtat Tjera Sendore.

Arsyeja e aplikimit të Ligjit të mëhershëm qëndron në faktin se baza  
juridike e kërkesëpadisë është krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë ky  
ligj.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të  
LPK-së, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjygjëse nuk i kërkuan  
shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.565/2013 Datë: 23.04.2015**



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat  
prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykates se Apelit në Prishtinë, e  
nëpërmjet kësaj gjykate.

*EP. PAGES SG. PAOTUR*

*07.23.04.2015*

*Durres*